



ANALIZË

QEVERISJA LOKALE NË RAPORTIN E PROGRESIT

*Prishtinë, Republika e Kosovës
Tetor, 2021*

Përmbajtja	
Hyrje.....	3
TEMAT E ADRESUARA NË FUSHËN E QEVERISJES LOKALE	4
Zgjedhjet Lokale dhe Përfaqësimi Gjinor	4
Kapacitetet Njerëzore dhe Financat Lokale.....	4
Shoqëria Civile dhe Qeverisja Lokale.....	4
Zhvillimi dhe Koordinimi i Politikave.....	5
Administrata Publike.....	5
Ofrimi i Shërbimeve për Qytetarët.....	5
Lufta ndaj Korrupsionit	6
Parandalimi i Diskriminimit dhe Mbrojtja Sociale	6
Plani Strategjik i Arsimit.....	7
Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe.....	7
Raportet/Rekomandimet e Auditorit.....	7

Hyrje

Raporti i Progresit 2021 shërben si pikë reference për institucionet e Bashkimit Evropian lidhur me vlerësimin e progresit të shtetit të Kosovës përgjatë rrugëtimit në BE. Në periudhën raportuese 2020-2021, fusha e qeverisjes lokale në Republikën e Kosovës është analizuar dhe vlerësuar në sektorë të ndryshëm. Vlerësimi i përgjithshëm i Raportit të Progresit është se ka pasur përpjekje për të përmirësuar kapacitetet e qeverisjes lokale.

Krahasuar me Raportin e Progresit të vitit të kaluar, është vërejtur një bashkëpunim më i theksuar midis shoqërisë civile dhe qeverive lokale. Ky përmirësim i bashkëpunimit kryesisht i referohet krijimit të Forumit Konsultativ për Qeverisjen Lokale, i cili është krijuar në vitin 2020 dhe përbëhet nga 19 organizata të shoqërisë civile dhe shërben si platformë për të diskutuar dhe për t'u konsultuar për çështjet e qeverisjes lokale.

Po ashtu, Raporti vlerëson se shoqëria civile në Kosovë vazhdon të luaj rol të rëndësishëm, me theks të veçantë në nivelin lokal. Në nivel lokal, konsultimet në komuna janë të integruara në Platformën e Përgjithshme online për konsultime publike, megjithatë zbatimi konsiderohet të jetë ende i mangët.

Raporti gjithashtu vendos theksin edhe tek zgjedhjet lokale të mbajtura me 17 tetor 2021, mirëpo vlerësimi do të lansohet nga një Mision të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të BE-së pas zgjedhjeve. Raporti paraqet që legjislacioni ligjor mbetet në thelb i pandryshuar që nga viti 2010, pavarësisht rekomandimeve të vëzhgimit të zgjedhjeve të shumta të BE -së dhe misioneve të ekspertëve.

Nën-përfaqësimi i grave në pozitë vendimmarrëse të qeverisjes lokale mbetet ende në nivel të njëjtë, kjo duke parë edhe faktin që nuk ka asnjë grua kryetare në ndonjë prej komunave të Kosovës.

Edhe pse nuk është evidentuar ndonjë progres sa i përket integritetit dhe konfliktit të interesit, përpjekje të mëtejshme janë duke u zhvilluar për të forcuar sistemet e prokurimit të qeverisjes lokale dhe mbikëqyrjen e auditimit dhe gjithashtu një numër i madh i komunave janë duke i publikuar kontratat e prokurimit.

Analiza përfshin një përmbledhje të përgjithshme të të gjeturave nga Raporti i Progresit për rezultatet dhe progresin e arritur në fushën e qeverisjes lokale nga viti 2021, njëherësh sfidat dhe kriteret kyçe që duhet adresuar viteve në vijim. Fushat e paraqitura në këtë analizë, njëherësh të vlerësuara nga Raporti i Progresit janë si në vijim: Zgjedhjet Lokale dhe Përfaqësimi Gjinnor; Kapacitetet Njerëzore dhe Financat Lokale; Shoqëria Civile dhe Qeverisja Lokale, Zhvillimi dhe Koordinimi i Politikave, Administrata Publike, Ofrimi i Shërbimeve për Qytetarët, Lufta ndaj Korrupsionit, Parandalimi i Diskriminimit dhe Mbrojtja Sociale, Lufta ndaj Terrorizmit dhe Procesi i Riintegritimit, Politikat e Punësimit, Plani Strategjik i Arsimit, Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe, Raportet/Rekomandimet e Auditorit.

Instituti KGLI ka analizuar Raportin e Progresit, me fokus çështjet që lidhen me pushtetin lokal, për më tepër edhe politikat qendrore që shtrihen në komuna. Ky dokument shërben për institucionet, akterët publikë, shoqërinë civile dhe mediat si pikë referuese për sfidat e qeverisjes lokale. Ndërkaq, për Institutin KGLI shërben si instrument në përshtatjen e strategjive dhe fushave të intervenimit në funksion të agjendës së përbashkët drejt reformave evropiane.

TEMAT E ADRESUARA NË FUSHËN E QEVERISJES LOKALE

- **Zgjedhjet Lokale dhe Përfaqësimi Gjinator**

- Raporti i Progresit vlerëson se legjislacioni zgjedhor mbetet në thelb i pandryshuar që nga viti 2010, pavarësisht rekomandimeve të vëzhgimit të zgjedhjeve të shumta të BE-së dhe misionëve të ekspertëve;¹
- Gratë ende mbesin të nën-përfaqësuara në pozitat vendimmarrëse të qeverisjes lokale;

- **Kapacitetet Njerëzore dhe Financat Lokale**

- Raporti i Progresit konstaton se ende vazhdon të ketë pabarazi të shprehura midis komunave në performancën dhe ofrimin e shërbimeve të tyre dhe kufizimet financiare dobësojnë aftësinë e komunave për të kryer mandatet e tyre demokratike lokale;
- Referuar Raportit, për shkak të kompetencave të kufizuara buxhetore, kuvendet komunale nuk luajnë një funksion të fortë mbikëqyrës mbi ekzekutivin komunal;
- Administratat komunale mbeten subjekt i ndikimit të panevojshëm politik;
- Raporti nuk evidenton progres në reformat legjislative të nevojshme për të riorganizuar financimin dhe kompetencat midis qeverive qendrore dhe lokale, për të përcaktuar më mirë financimin e komunave bazuar në kritere të qarta, të drejta dhe transparente dhe për të krijuar një grant specifik për shërbimet sociale;
- Raporti rekomandon që ministritë e qeverisë qendrore duhet të përcaktojnë dhe zbatojnë kritere të bazuara në rregulla, të drejta dhe transparente kur shpërndajnë fonde për qeveritë vendore.²

- **Shoqëria Civile dhe Qeverisja Lokale**

- Raporti evidenton bashkëpunim më të theksuar midis shoqërisë civile dhe qeverisjes lokale;
- Përmirësim i bashkëpunimit kryesisht i referohet krijimit të Forumit Konsultativ për Qeverisjen Lokale, i krijuar në vitin 2020 dhe i përbërë nga 19 organizata të shoqërisë civile dhe shërben si platformë për të diskutuar dhe për t'u konsultuar për çështjet e qeverisjes lokale;
- Raporti thekson se ka pasur progres të kufizuar në lidhje me Strategjinë për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile për periudhën 2019-2023 dhe planin e saj të veprimit;
- Referuar Raportit, konsultimet në komuna janë të integruara në Platformën e përgjithshme online për konsultime publike, megjithatë zbatimi është ende i mangët.

¹ Raporti i Progresit 2021 për Kosovën. Kapitulli i Demokratizimit”, f.8

² Kapitulli i Qeverisjes, f.10, 11

- Burimet njerëzore dhe financiare për të zbatuar planin e strategjisë mbeten të kufizuara dhe vazhdojnë të mbështeten jashtë mase në bashkëfinancimin e donatorëve.³
- **Zhvillimi dhe Koordinimi i Politikave**
 - Raporti i Progresit vlerëson progres në ngritjen e politikave përfshirëse të bazuara në dëshmi dhe zhvillimin legjislativ;
 - Konsultimet publike vazhdojnë të organizohen rregullisht, mirëpo jo në mënyrë sistematike;
 - Zbatimi konsistent i Ligjit për Qasjen në Dokumentet Publike mbetet i nevojshëm, si dhe emërimi i pikave të kontaktit të të dhënave brenda administratës.⁴
- **Administrata Publike**
 - Sipas Raportit, ekziston një nivel i përgatitjes në fushën e reformës së administratës publike, mirëpo nuk ka pasur progres në implementimin e rekomandimeve të vitit të kaluar për shkak të ndërrimeve e shpeshta të qeverisë;
 - Sa i përket procesit të rekrutimit të zyrtarëve publikë, Raporti thekson se ndikimi i panevojshëm politik mbi emërimet dhe shkarkimet e funksionarëve të lartë publikë dhe nëpunësve civilë është vërejtur në disa raste dhe Kosova ka përmbushur vetëm disa nga obligimet e saj për kriteret e bazuara në merita;
 - Nuk është evidentuar progres në adresimin e pabarazive në sistemin e pagave të sektorit publik;
 - Raporti i Progresit rekomandon që Kosova të fillojë zbatimin efektiv të Ligjit për Zyrtarët Publikë në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese;
 - Raporti i Progresit rekomandon që Kosova të harmonizojë ligjet kontradiktore me Ligjin për Procedurat e Përgjithshme Administrative dhe të adresojë numrin e madh të çështjeve gjyqësore administrative.⁵
- **Ofrimi i Shërbimeve për Qytetarët**
 - Sipas Raportit të Progresit, nuk ka asnjë politikë koherente, të drejtuar nga qendra në ofrimin e shërbimeve publike me në qendër përdoruesit;
 - Raporti i Progresit thekson se përgjegjësitë institucionale për zhvillimin e politikave në ofrimin e shërbimeve publike duhet të sqarohen dhe mekanizmat efektivë të koordinimit në nivelin qendror mungojnë dukshëm;

³ Kapitulli i Shoqërisë Civile, f.11, 12

⁴ Kapitulli i Reformës së administratës publike”, f.13

⁵ Po aty, f.12

- Raporti rekomandon që të përmirësohen më shumë platformat ndërinstitucionale të shkëmbimit të të dhënave (sikurse eKosova) dhe të trajtohen sfidat e mëdha ligjore, operacionale dhe teknike;
- Raporti i Progresit e konsideron problematike çështjen e ndarjes së financimit nga komunat për shërbimet sociale edhe në vitin 2020;
- Raporti rekomandon që komunat të përmirësojnë planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve, mbledhjen e të dhënave dhe kujdesin e integruar.⁶

- **Lufta ndaj Korrupsionit**

- Raporti i Progresit thekson që ekziston një nevojë e vazhdueshme për të promovuar elaborimin dhe miratimin e planeve të integritetit për shërbimin publik si mjet për parandalimin e korrupsionit dhe vendosjen e disiplinës, përfshirë në nivel komunal;
- Raporti rekomandon bashkëpunim më të thellë dhe shkëmbim të të dhënave me Policinë, Administratën Tatimore të Kosovës, Njësinë e Inteligjencës Financiare dhe të forcohet regjistri kadastral dhe autoritetet komunale.⁷

- **Parandalimi i Diskriminimit dhe Mbrojtja Sociale**

- Raporti i Progresit vlerëson se roli i zyrtarëve kundër diskriminimit në komuna dhe ministri, duhet të forcohet me linja të qarta të raportimit dhe përkrahje të detyrave;
- Koordinimi me zyrtarët për barazi gjinore në ministri dhe komuna duhet gjithashtu të forcohet;
- Për martesat e hershme dhe të detyruara të fëmijëve që mbeten të spikatura në komunitetet Romë dhe Ashkali, Raporti i Progresit rekomandon që komunat të sigurojnë fonde të qëndrueshme për qendrat e mësimi parashkollor për fëmijët e këtyre komuniteteve;
- Kujdestaria për fëmijët pa përkujdesje prindërore nuk aplikohet në të gjitha komunat e Kosovës dhe nuk i plotëson kushtet për kujdes ndaj fëmijëve pa përkujdesje prindërore⁸;
- Raporti thekson se punësimi i personave nga komunitetet joshumicë në sektorin publik është ende nën pragun 10% të përcaktuar me legjislacionin përkatës - këto komunitete përgjithësisht mbeten të nën-përfaqësuara në shërbimin civil si në nivelin qendror, ashtu edhe në atë komunal;
- Raporti i Progresit konsideron që shkalla e braktisjes së shkollës mbetet e lartë në mesin e fëmijëve Romë, Ashkali dhe Egjiptianë;
- Raporti paraqet nevojë të theksuar në Kosovë për rritjen e mbështetjes ndaj ekipeve komunale për parandalimin e braktisjes së shkollës.⁹

⁶ Kapitulli i Reformës së administratës publike, f.15

⁷ Kapitulli i Luftës kundër Korrupsioni, f.25

⁸ Kapitulli i Të Drejtave Fundamentale, f.35

⁹ Po aty, f.36

- **Plani Strategjik i Arsimit**

- Raporti tregon se është arritur pak progres në reformimin e sistemit arsimor;
- Regjistrimi i fëmijëve në arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm është universal, mirëpo pjesëmarrja e fëmijëve në arsimin dhe kujdesin e hershëm shkollor (3-5 vjeç) është ende mjaftë e ulët, sipas Raportit;
- Raporti e konsideron sfidues problemin e vazhdueshëm të ndarjes urbane-rurale, varfërisë ekstreme dhe mungesës së objekteve arsimore.¹⁰

- **Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe**

- Raporti tregon se nuk ka pasur progres të mëtjshëm në zbatimin e marrëveshjes të 25 gushtit 2015¹¹;
- Punimet në urën e Mitrovicës kanë përfunduar prej kohësh dhe ura duhet të hapet për qarkullimin e automjeteve pa vonesa apo pengesa të mëtjshme, theksohet në Raport.

- **Raportet/Rekomandimet e Auditorit**

- Raporti thekson se funksionimi i kontrollit të brendshëm dhe auditimit dhe zbatimi në kohë i rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm duhet të forcohen;
- Raporti rekomandon që Kosova duhet të përmirësojë zbatimin më sistematik dhe në kohë të rekomandimeve të auditimit të jashtëm, veçanërisht në lidhje me auditimet e performancës që janë ndërmarrë vitet e fundit;
- Raporti e konsideron sfidues themelimin efektiv të komiteteve të auditimit të brendshëm në të gjitha organizatat buxhetore, duke përfshirë edhe nivelin komunal;
- Zyra Kombëtare e Auditimit finalizoi 11 raporte të auditimit të performancës, krahasuar me 8 në vitin 2020. Zyra ka punuar me organizatat e shoqërisë civile, veçanërisht në nivel lokal, për të përmirësuar ndikimin e punës së auditimit.¹²

¹⁰ Kapitulli i Edukimit dhe Inovacionit, f.59

¹¹ Kapitulli i Normalizimit të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, f. 70

¹² Kapitulli i Kontrollit Financiar, f.66



Kosovo Local Government Institute
"Egnatia" Ulpianë, H-9, Kati-4, Nr. 16, 10000
Prishtinë, Republic of Kosova
Tel: +383 (0) 38 522 000
Mobile: +383 (0) 44 253 835
E-mail: info@klgi-ks.com | Web: www.klgi-ks.com